



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.930/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, Visar Osdautaj, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Komunën e Deçanit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.930/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, Visar Osdautaj, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Deçan, kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për Kuvendin Komunal, për shpalljen e rezultatit përfundimtar, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen votat në vendvotimet nr. 0113/02D, 0110C/01R

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 04.11.2021 nga anëtari për Kuvend Komunal në Komunën e Deçanit, Visar Osdautaj nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Komunën e Deçanit, me të cilën pretendon se në vendvotimin 0113/02D në fshatin Beleg, Komuna e Deçanit më datën 17.10.2021 pas orës 19:00 gjatë procesit të numrimit të votave janë paraqitur akte kriminale nga personat zyrtarë siç thekson sipas Kodit Penal ka pasur keqpërdorim të detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve dhe falsifikimi i rezultateve. Në Vendvotimin nr.0110C/01R në fshatin Lumbardhë ka mungesë të votave sepse raportimet e komisionerëve dallojnë me rezultatet e publikuara në Formularin e Rezultateve për Kandidat (FRK) dhe pretendon se ka pasur falsifikime të rezultatit nga persona zyrtar. Andaj përmes apelit ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në Vendvotimet 0113/02D, 0110C/01R

Si provë ka bashkangjitur kopjet e dokumenteve indentifikues (letërnjoftimet) të tre personave me të cilën pretendon se e kanë votuar dhe një kopje e një mesazhi nga telefoni i votuesit të pretenduar. PZAP-i, pasi që shqyrtoi apelin, vlerësoi se:

## Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtuesi i apelit kërkon që të rinumërohen vendvotimet 0113/02D, 0110C/01R, në Komunën e Deçanit.

Paneli, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, nga kopjet e dokumenteve identifikues si dhe kopjen e një komunikimi ne rrjetet sociale te internetit e bashkangjitur nga parashtuesi i apelit nuk vërteton rrethana se votuesit e pretenduar të cekur në apel nuk kanë kurrfarë teksti të deklarimit dhe se me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se sa vota i mungojnë si dhe parregullsit e cekura gjatë procesit të numrimit, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime të votave, për faktin se thëniet e apelit nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë theksuar si te tilla ne apele, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit dhe mungesë të votave, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtuar nga Visar Osdautaj, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

Anr.930/2021 më datë 07.11.2021



Kryesues i Panelit  
Burim Ademi

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.